

22.01.2022
Ora 10:44

RENDI I DITËS

Projektudhëzim “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y.Merkaj, Znj. I. Osmanaj

• **Parti Politike:**

PD(L.Sefa, M.Logu), LSI (A.Kaziaj)

Z. Ivi Kaso

Z. I. Celibashi: Mirëmëngjes të gjithëve! Fillojmë seancën publike për shqyrtimin e çështjeve që kemi sot në rendin e ditës.

Pika e parë ka të bëjë me projektudhëzimin “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.1, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimit të dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”.

Pika e dytë ka të bëjë me projektvendimin “Për përcaktimin e mënyrës së administrimit të dokumentacionit zgjedhor e të asgjësimit të fletëve të votimit për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill të vitit 2021”.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

Pika e tretë e rendit të ditës ka të bëjë me projektvendimin “Për miratimin e procedurave operationale për shkatërrimin e të dhënave personale në pajisjen elektronike të identifikimit PEI-n, dhe sistemin elektronik të identifikimit të votuesve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”.

Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me projektudhëzimin “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.1, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që ka të bëjë me përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”. Fjala për ju zoti sekretar!

Z. Y. Merkaj: Në mbështetje të nenit 2 dhe nenit 93/115 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës, me dekretin numër 13438, datë 20.01.2022 ka caktuar datën 6 Mars 2022 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, në këto njësi të qeverisjes vendore: Bashkia Shkodër, Bashkia Dibër, Bashkia Durrës, Bashkia Vorë, Bashkia Rrogozhinë dhe Bashkia Lushnje. Në mbështetje të nenit 19 të Kodit Zgjedhor, 67, 68, 69, 70 dhe në vijim të Kodit Zgjedhor, si dhe Ligjit nr. 138, të vitit 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe nenit 144, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka propozuar që modeli nr. 03/1 dhe modeli 05 në Udhëzimin nr.1, datë 23.12.2020, të zëvendësohet me modelet me të njëjtin numër bashkëlidhur këtij udhëzimi duke përshtatur këto modele me zgjedhjet vendore, pasi kanë qenë miratuar për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Bashkëlidhur keni projektudhëzimin, si dhe dy modelet që propozoj të miratohen, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, sikurse u prezantua dhe nga sekretari, ndryshimet janë të karakterit teknik dhe thjesht dhe vetëm reflektojnë natyrën e dokumentacionit të kandidimit që lidhet me zgjedhjet e pjesshme të 6 marsit, zgjedhje për organet e qeverisjes vendore në këto 6 bashki. Përfaqësuesit e partive politike, nëse duan të shprehen në lidhje me këtë projektakt?

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Zoti Celibashi, siç jeni në dijeni, doja një parashtesë procedurale në fakt. Siç jeni në dijeni, ju ka ardhur dhe një kërkesë nga Partia Demokratike, e cila ka legjitimuar si përfaqësues të saj, në bazë të nenit 26 të Kodit Zgjedhor, mua si sekretar i çështjeve ligjore dhe zgjedhore, zotin Indrit Sefa dhe zotin Marash Logu, si zëvendësin tim. Ju lutem që kjo të reflektohet dhe pasqyrohet edhe në administratën e KQZ-së, si dhe të marrë të gjitha kontaktet për t'u lajmëruar në vazhdim në të gjitha mbledhjet, edhe si përfaqësues të vetëm të Partisë Demokratike në këtë proces.

Z. I. Celibashi: Po, mund të vazhdoni! Kemi marrë një shkresë nga kryetari i Partisë Demokratike në lidhje me përfaqësimin e saj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe sipas shkresës, përfaqësues të kësaj partie, jeni ju dhe zoti Marash Logu. E shoh që keni në krah edhe kolegun tuaj dhe kolegun tonë, zotin Ivi Kaso, i cili deri dje ka patur përfaqësimin e kësaj partie dhe për mos t'u fshehur mbas gishtit, nuk mund të mos e prezantoja këtë si fakt, përderisa dhe zoti Kaso është aty.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Më falni për ndërhyrjen! Ne mirëkuptojmë që është lajmëruar për mbledhjen, normalisht sepse dhe shkresa ka ardhur vetëm dje, por nga vazhdimi e tutje...

Z. I. Celibashi: Jemi të qartë në këtë dhe unë e konfirmova. Kam edhe shkresën e kryetarit të partisë, i cili njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve mbi personat që e përfaqësojnë partinë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Po, zoti Kaso!

Z. I. Kaso, përfaqësues politik: Faleminderit zoti Komisioner! Së pari ju uroj suksese në procesin zgjedhor që sapo është dekretuar nga presidenti dhe vlerësoj gjithashtu shpejtësinë me të cilin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka çelur procedurat për miratimin e akteve, vetëm dy ditë pas dekretimit të tyre. Lidhur me atë ç'ka u relatua, ç'ka relatuar edhe ju, sigurisht do të donim të njiheshim me një shkresë të tillë, por paraprakisht bëj me dije Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që së pari jemi në një periudhë ende parazgjedhore. Pra, që përfaqësimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve vijon automatikisht dhe për inerci për subjektet zgjedhore që kanë marrë pjesë në garat zgjedhore të kaluara, pasi nuk kemi asnjë subjekt zgjedhor të regjistruar në garë. Le të themi që nuk hyjmë në ato rregullat e posaçme që parashikon Kodi Zgjedhor për subjektet garuese. Kjo në përgjithësi përsa i përket kontekstit që zhvillohet mbledhja. Së dyti, dua të bëj me dije Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për një fakt të bërë publik dhe të njohur botërisht, për të cilin janë njoftuar edhe institucionet përkatëse, nominalisht edhe Kuvendi i Shqipërisë, nga i cili, le të themi, jo varet, por përpara të cilit raporton Komisioni Qendror i Zgjedhjeve si institucion i pavarur. Njoftim ky lidhur me faktin që, prej datës 11 dhjetor 2021, jo vetëm nënshkruesi i letrës, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, siç u relatua nuk është më kryetar i Partisë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

Demokratike, por me vendim të 4935 delegatëve të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, që është organi më i lartë drejtues i saj, sigla dhe vula e Partisë Demokratike ka ndryshuar në raport me ato ç'ka ishin depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në procesin zgjedhor të 25 prillit, proces ky i konkluduar. Sigurisht pasi të njihen me letrën mund të mbajnë dhe një qëndrim zyrtar në emër dhe për llogari të Partisë Demokratike lidhur me këtë lloj komunikimi, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Paraprakisht, kjo ishte paranteza lidhur me pjesën e nënshkrimit dhe pjesën e vulosjes së shkresës drejtuar juve, sikundër ju relatuat. Gjithsesi, besoj që momenti procedural, në të cilën do të verifikohet, do të duhet të verifikohet kjo gjë nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ka për të qenë dhe nuk mund të jetë tjetër përveç se ai i regjistrimit të subjekteve zgjedhore në garë, në qoftë se ky regjistrim do të ndodhë brenda afteve që ju do të miratoni sot, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit zoti Kaso! Mendoj që nga pikëpamja e ligjit, raporti i një partie politike me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është një raport, i cili është në kuptim të kohës i vazhdueshëm, qoftë gjatë periudhës zgjedhore, qoftë edhe gjatë periudhës jozgjedhore. Ekziston një marrëdhënie për atë sa ligji e përcakton këtë marrëdhënie. Duke qenë se është marrëdhënie ndërmjet dy institucioneve, secili prej këtyre institucioneve ka mënyrën e vet dhe e demonstron në mënyrë të ligjshme përfaqësimin e ndërsjellë. Me gjithë keqardhjen që kam në lidhje me këtë situatë realisht, por do të duhet të pranojmë që jemi në një marrëdhënie institucionale ndërmjet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Partisë Demokratike si një parti politike ku ai që është përfaqësues ligjor i saj, e demonstruar kjo deri më sot nga aktet zyrtare, ka konsideruar që cilët do të jenë përfaqësuesit e saj në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Kështu që më duhet të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

them që për ju kjo ishte fjala e fundit në lidhje me këtë çështje dhe me vazhdimin e mëtejshëm të mbledhjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Opinionet dhe mendimet e Partisë Demokratike në lidhje me këto akte janë ato të cilat do të prezantohen nga zoti Indrit Sefa dhe zoti Marash Logu, faleminderit!

Z. I. Kaso, përfaqësues politik: Mund të më jepet një kopje e akteve që të mbaj një qëndrim zyrtar?


Z. I. Celibashi: Po, patjetër! Po këtu në kuadër të gjithë konceptit të transparencës që ne përpqemi të adaptojmë në lidhje me punën e KQZ-së, me siguri që një kopje të këtyre akteve do t'ju vihet në dispozicion, patjetër.

Z. I. Kaso, përfaqësues politik: Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim?

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Faleminderit zoti Komisioner! Ju uroj një vit të mbarë fillimisht, gjithë administratës së KQZ-së. Përsa i përket pjesës, thirrjes tuaj për të qenë prezent lidhur me miratimin e akteve që kemi përpara nesh, unë kisha dy gjëra fare të shkurtra. Akti i parë është një udhëzim i cili ndryshon pjesërisht në dy modelet e veta Udhëzimin nr.1, datë 23.12.2020. Normalisht janë përshtatur, ashtu si tha edhe Sekretari i Përgjithshëm, duke qenë se jemi përpara zgjedhjeve të pjesshme vendore. Fakti është që ka ndryshuar viti, por nuk ka ndryshuar sjellja, në thonjëza. Do donim pak, duke mirëkuptuar dhe pjesën e ngarkesës që ka administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do të donim pak që komunikimet, e kemi thënë dhe në 2021, komunikimet për ftesa, për të qenë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

prezent të ne anëtarëve, ose përfaqësuesve të partive, të subjekteve tona respektive, të ishin në një orar të përshtatshëm, në mënyrë që të na lihej koha për t'u organizuar lidhur me to. Kaq kisha, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Në lidhje me projektaktin, nuk kemi ndonjë gjë? Mendoj që qëndron konsiderata juaj, por besoj që kemi edhe mirëkuptimin tuaj për shkak të kohës shumë të shkurtër, në të cilën ne do duhet të rikonsiderojmë përmbajtjen e disa akteve dhe kohës po kaq të shkurtër që kemi në dispozicion për t'i zhvilluar këto zgjedhje, kështu që do duhet të na mirëkuptoni për këtë. Faleminderit! Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Jam dakord zoti Komisioner, në lidhje me atë ç'ka parashtroi parafolësi, në lidhje me kohën, sepse edhe ne duhet që të kemi kohë të përshtatshme për t'i studiuar, për të mbajtur një qëndrim konkret dhe ligjor. Në lidhje me ndryshimet jemi dakord, janë thjesht çështje administrimi që normalisht edhe Komisioneri edhe KQZ-ja i ka vlerësuar si të nevojshme.

Z. I. Celibashi: Dakord, faleminderit! Edhe njëherë për ta përfunduar argumentin në lidhje me kohën. Besoj që jemi të gjithë koshientë që koha e shkurtër në të cilat zhvillohen këto zgjedhje, na imponon që afatet t'i kemi me orë në kuptim të shqyrtimit të drafteve që ne ju dërgojmë. Nëse do jetë rasti që do kërkoni kohë më shumë, ne këtu jemi dhe përse do të jetë e mundur do ta ofrojmë këtë mundësi. Mirë, faleminderit! Atëherë meqenëse kemi dakordësinë e të gjithëve në lidhje me përmbajtjen e projektaktit, e miratojmë projektaktin sipas përmbajtjes së propozuar.

Udhëzimi nr. 1

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

22.01.2022
Ora 11:00

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për përcaktimin e mënyrës së administrimit të dokumentacionit zgjedhor e të asgjësimit të fletëve të votimit për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y.Merkaj, Znj. I. Osmanaj

• **Parti Politike:**

PD(I.Sefa, M.Logu), LSI (A.Kaziaj)

Z. Ivi Kaso

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me projektvendimin për përcaktimin e mënyrës së administrimit të dokumentacionit zgjedhor e të asgjësimit të fletëve të votimit për hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Z. Y. Merkaj: Presidenti i Republikës me dekretin e datës 20.01.2022 ka caktuar datën 6 Mars 2022 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore, të kryetarëve të bashkive, në këto njësi të qeverisjes vendore: Bashkia Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Referuar nenit 178, pika 6 e Kodit Zgjedhor parashikon se 6 muaj pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, sipas

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

këtij Kodi, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve hap të gjitha kutitë e votimit, nxjerr procesverbalet e votimit, tabelat e procesverbaleve të numrit të fletëve të votimit, dokumentacionin që ndodhet në kutinë e materialeve të votimit dhe ia dërgon ato Arkivit Qendror të Shtetit, në mënyrë të caktuar prej tij. Të gjitha fletët e votimit asgjësohen sipas mënyrës përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në mbështetje të nenit 19, pika 1 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve propozon që fletët e votimit të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 dhe fletët e votimit të printuara nga pajisjet elektronike të votimit dhe të numërimit PEVN, të asgjësohen me mënyrën e riciklimit. Procedura për asgjësimin nëpërmjet riciklimit do t'iu nënshtrohet rregullave të përcaktuara në ligjin për ankandin public. Kurse të dhënat biometrike të pajisjeve të identifikimit elektronik të zgjedhësve dhe dokumenteve të printuara nga pajisjet PEI, me të dhënat sensitive të zgjedhësve do të asgjësohen në përputhje me një udhëzim të posaçëm të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Në lidhje me projektaktin në parim, fillimisht kemi ndonjë diskutim?

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Unë, i nderuar, kisha një pyetje në qoftë se mundem, lidhur me pikën 2 të këtij projektvendimi.

Z. I. Celibashi: Në parim fillimisht, jeni dakord? Përfaqësuesi i LSI-së, jeni dakord? Po! Atëherë vazhdojmë me diskutimin në lidhje me përmbajtjen e projektaktit.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Më shumë informacion, sesa kemi ndonjë kundërshti lidhur me pikën 2, ku thuhet që: “kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore, të cilat janë evidentuar indicie për kallëzimet penale apo janë vendosur sekuestro nga organet kompetente”, a mund të kemi një informacion, mbase nga administrata e KQZ-së? Sa është numri i këtyre materialeve, të cilat kanë qenë kallëzimet? Pra, cilat janë arsyet, po themi, që ka dhe për çfarë po flasim konkretisht? Ke diçka më shumë informacion rreth kësaj pike? Sa është numri i kutive që aktualisht janë në sekuestro? Cilat janë kallëzimet penale, procedimet penale, etj, etj? A lidhen ato me kallëzime penale të depozituara nga subjektet zgjedhore në zgjedhjet e 25 Prillit 2021?


Z. I. Celibashi: Besoj si numër kutish nuk e kemi këtë!

Z. Y. Merkaj: Për numrin e kutive nuk mund të japim përgjigje tani për momentin!

Z. I. Celibashi: Atëherë për të sqaruar, në princip kuptimi i kësaj përmbajtjeje konsiston në atë që, të gjitha ato kuti të materialeve zgjedhore, apo kuti të fletëve të votimit, që iu përkasin atyre qendrave të votimit, për të cilat Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë kallëzim në organet përkatëse, për natyra të ndryshme të shkeljeve penale, nuk do të hapen dhe nuk do të asgjësohet materiali zgjedhor. Vlen kjo edhe për të gjitha ato kuti votimi, për të cilat organi i prokurorisë mundet të ketë disponuar me akte proceduriale për të vendosur sekuestro konservative. Kjo është kategoria e këtyre. Mbetet, që besoj që i përfshin të gjithë kuadrin e atyre kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore, për të cilat mund të ketë interes të mëtejshëm në kuadër të hetimeve të caktuara. Ndërsa për kutitë e votimit të

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

qendrave të votimit, për të cilat subjekte të tjera zgjedhore, subjektet zgjedhore, përfshirë edhe subjektin tuaj zgjedhor, ka bërë kallëzim, sa kohë që nga organi i prokurorisë ne nuk kemi ndonjë vendim, nuk i kemi përfshirë këtë. Por, mund ta diskutojmë nëse mendoni që është vendi, dhe në mënyrë racionale edhe këto kuti ne mundet t'i përfshijmë.

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: I nderuar, ne do kishim interes në fakt, që të kishim më shumë informacion nga ana e administratës në një kohë të arsyeshme, se sigurisht mbase edhe administrata ka qenë e ngarkuar gjatë kësaj periudhe, lidhur me kutitë për të cilat janë vendosur sekuestro nga organet kompetente. Siç e thashë edhe më përpara, Partia Demokratike si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e 25 Prillit 2021 ka depozituar një numër të konsiderueshëm kallëzimesh penale që lidhen me parregullsi të procesit zgjedhor. Ne do ishim të interesuar, qoftë edhe të njihen vetëm përfaqësuesit, pra pa pasur nevojë në qoftë se e kërkon detyra që mos të jetë publike, të njihemi me ato kuti për të cilat organi procedues ka kërkuar sekuestron e tyre. Këtë si informacion brenda një kohe të arsyeshme, ndërkohë që lidhur me vetë aktin, projektvendimin e propozuar, nuk kemi ndonjë rezervë apo kundërshti.

Z. I. Celibashi: Patjetër, menjëherë pas përfundimit të kësaj mbledhjeje ne do t'ju japim informacion për të gjitha ato kuti votimi, të cilat përfshihen në këtë kategori. Pra, për të cilat ne si institucion kemi konsideruar që duhet të jenë pjesë eventualisht e materialeve mbi të cilat mund të disponojë organi i prokurorisë. Po kështu dhe ato kuti të atyre qendrave të votimit, votimi apo materialeve zgjedhore, të cilat organi i prokurorisë ka vendosur sekuestron. Kështu që patjetër! Po, përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Unë shoh që akti i dytë që do të shkojë për të miratuar ju, është në mungesë përsa i përket pjesës së një relacioni shoqërues, i cili shpjegon arsyet dhe qëllimin se pse po shkojmë të miratojmë një akt të tillë. Kërkojmë shumë miqësisht, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, që të gjitha aktet që miratohen nga ana e tij, ose propozohen për t'u miratuar të jenë të mirëspecifikuara nga një relacion shoqërues për qëllimin e miratimit të aktit dhe arsyet e miratimit të aktit, ndërkohë që në këtë akt nuk e shohim.

Z. Y. Merkaç: Tek relatimi e thashë, është neni 178, pika 6, e cila përcakton se 6 muaj pas përfundimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, materialet, fletët e votimit, procesverbalet dhe të gjitha materialet që ndodhen në kutinë e votimit dhe në kutinë e materialeve zgjedhore asgjësohen dhe një pjesë shkon tek Arkivi i Shtetit. Është detyrimi i Kodit Zgjedhor dhe në bazë të këtij detyrimi Komisioneri do të përcaktojë mënyrën e asgjësimit.

Z. I. Celibashi: Nuk e kundërshtoi këtë, tha tjetër gjë kam përshtypjen përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim. Tha që projektakti do të duhej të kishte, pikërisht që ju e thatë, të ishte e shkruar dhe të ishte e argumentuar sikurse është praktika. Justifikohemi kot tek kjo gjëja dhe mendoj se qëndron si vërejtje. Kemi diskutim tjetër? Jo! Mirë, atëherë kalojmë në procedurë votimi, vlerësimi dhe miratimi. Në lidhje me përmbajtjen e pikës 1 jemi dakord, po kështu në lidhje me përmbajtjen e pikës 2, por me shtesën që do të përcillet informacioni përkatës për çfarë përkufizon kjo pikë. Po kështu dhe pika 3, pika 4, pika 5, pika 6, pika 7, pika 8, pika 9. Atëherë e miratojmë aktin edhe në tërësi sipas projektit të prezantuar.

Vendimi nr. 3

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

**22.01.2022
Ora 11:09**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e procedurave operationale për shkatërrimin e të dhënave personale në pajisjen elektronike të identifikimit (PEI) dhe sistemin elektronik të identifikimit të votuesve (SEIV) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y.Merkaj, Znj. I. Osmanaj

• **Parti Politike:**

PD(I.Sefa, M.Logu), LSI (A.Kaziaj)

Z. Ivi Kaso

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek pika e tretë e rendit të ditës, që ka të bëjë me “Miratimin e procedurave operationale për shkatërrimin e të dhënave personale në pajisjen elektronike të identifikimit dhe sistemin elektronik të identifikimit të votuesve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të përdorura këto në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”.

Z. Y. Merkaj: Presidenti i Republikës ka caktuar datën 6 Mars 2022 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Mbështetur në nenin 14 dhe 19 të Kodit Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

Zgjedhjeve propozoi miratimin e procedurave operationale për shkatërrimin e të dhënave personale në pajisjet elektronike të identifikimit, pajisja e njohur si pajisja PEI, të përdorura për identifikimin elektronik të zgjedhësve në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021. Të dhënat personale që disponon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zhvillimin e zgjedhjeve si dhe të dhënat biometrike, të cilat janë të ruajtura në pajisjen PEI, si dhe në serverat e bazave të të dhënave në *datacenter* të *primar* dhe *secundar* do të asgjësohen sipas hapave të përcaktuara në lidhjen bashkëlidhur këtij vendimi. Procesi i asgjësimit të të dhënave sipas pikës 1 të këtij vendimi është parashikuar të bëhet në prani të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të partive politike, të OJF-ve, si dhe të medias. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe procedurat dhe hapat që do të ndiqen për asgjësimin e këtyre të dhënave, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Besoj se qëndron vërejtja juaj dhe për këtë rast sepse duket që i mungon relacioni i shkruar dhe nuk e di pse nuk e keni dërguar, por mendoj që koha dhe ngarkesa mund të jetë një lloj justifikimi. Gjithësesi do duhet që të mos përsëritet më në të ardhmen. Atëherë edhe njëherë me pak fjalë, qëllimi i këtij projektakti është që të përcaktojë procedurat që lidhen me asgjësimin e të gjitha të dhënave personale dhe të dhënave biometrike të përfituara nga procesi të votuesve shqiptarë, të përfituara gjatë procesit të identifikimit elektronik në zgjedhjet e 25 prillit. Është e kuptueshme që ky është një akt shumë i rëndësishëm, pasi lidhet me sigurinë në administrimin dhe përdorimin e të dhënave personale dhe atyre biometrike të shtetasve shqiptarë. KQZ ka demonstruar të paktën deri tani, por edhe më tej më tepër akoma me këtë akt, përgjegjësinë dhe seriozitetin në lidhje me këtë çështje kaq sensitive. Nëpërmjet këtij akti ne i përcaktojmë qartë të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

gjitha procedurat, të cilat janë transparente. Do të zhvillohen në prani, më së pari të Komisionerit për Mbrojtjen dhe të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, partive politike, të cilat mund të autorizojnë përfaqësuesit e tyre gjatë këtij procesi, shoqërisë civile dhe medias. Kemi diskutime në parim? Po, jemi dakord në parim! Përfaqësuesit e partive politike janë dakord në parim? Po përfaqësuesit e partive politike janë dakord në parim! Në lidhje me përmbajtjen e këtij akti? Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së: Edhe në këtë projektvendim i nderuar, shohim që në pikën 3 thuhet “Të dhënat biometrike për të cilat nga procesi i kryqëzimit dhe të dhënave ka rezultuar votim i shumëfishtë dhe është bërë kallëzim në organet përkatëse të ruhen deri në përfundim të hetimit”. Një nga rastet në të cilat Partia Demokratike ka evidentuar si parregullsi apo shkelje gjatë procesit zgjedhor të 25 prillit, kanë qenë edhe disa raste për të cilat ekzistonin dyshime të arsyeshme të votimit të shumëfishtë. Duke qenë se kemi një interes të drejtpërdrejtë në këtë çështje, do të donim që të njiheshim, konkretisht për të dhënat, po themi, që ka të bëjë kjo pikë. Ashtu siç e tha edhe kolegu i LSI-së, dhe në këtë pikë jemi dakord, mbase në një relacion paraprak mund të ishte bërë kjo e mundur, në të ardhmen besoj do reflektohet. Në këtë pikë që jemi do të donim që brenda një kohe të arsyeshme të njihemi edhe me informacionin që lidhet me këtë pikë, duke qenë se një nga subjektet zgjedhore që ka denoncuar apo ka kallëzuar raste të tilla është edhe Partia Demokratike e Shqipërisë. Kisha dhe dy gjëra të tjera që janë më shumë pyetje, i nderuar, sesa kundërshti të vetë aktit. Identifikimi elektronik i zgjedhësve ishte një risi e zgjedhjeve të 25 prillit, për të cilin sigurisht të gjitha subjektet dhe partitë politike kanë qenë dakord dhe e kanë mbështetur. Megjithatë një proces, i cili implementohet për herë të parë ka pasur edhe problematikat e tij

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

dhe është krejt e pritshme. Së pari, do të doja të dija në zgjedhjet e 6 marsit, në zgjedhjet e pjesshme vendore, cilat janë masat e marra apo që do merren nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të garantuar që edhe në këto zgjedhje do të funksionojë identifikimi elektronik i zgjedhësve? Gjithashtu, në qoftë se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pasur kohën e nevojshme për të bërë një analizë të atyre çfarë nuk ka shkuar mirë në zgjedhjet e 25 prillit dhe ka arritur të marrë ndonjë masë apo disa masa për përmirësimin e atyre që mund të përmirësonim? Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Në lidhje me informacionin, edhe këtë lloj informacioni, besoj do ta keni brenda ditës së sotme. Mbjatëm shënim edhe në lidhje me vërejtjen për mënyrën e prezantimit të aktit. Në lidhje me përdorimin e sistemit të identifikimit elektronik në zgjedhjet e 6 marsit, mendoj që ky është një detyrim ligjor për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është i detyruar që ta përmbushë, edhe pse do duhet ta them dhe kjo jo për t'u justifikuar. Qoftë edhe për faktin që pajisjet të cilat janë përdorur në zgjedhjet e 25 prillit janë akoma të ngarkuara me të dhënat e përfituara nga procesi i identifikimit dhe kjo do të na marrë kohë për t'i bërë pajisjet gati, shto këtu dhe faktin që dhe vetë zgjedhjet zhvillohen në një periudhë shumë të shkurtër nga momenti i dekretimit deri në zhvillimin e tyre. Duke qenë një detyrim ligjor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të duhet ta bëjë këtë procedurë. Natyrshëm që do të kërkojë impenjime njerëzore dhe financiare shtesë, pasi njëkohësisht do të duhet që të bëjmë asgjësimin e të dhënave, ndërkohë t'i përgatisim pajisjet për zgjedhjet e radhës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë një analizë të të gjithë procesit zgjedhor, ka kohë që e ka përfunduar këtë analizë. Ashtu sikurse dhe për aspekte të tjera të procesit zgjedhor dhe më shumë akoma për këtë aspekt, i cili ka

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.22.01.2022*

qenë një risi dhe është zhvilluar në raport me kohën në kushte jo shumë të përshtatshme. Tashmë pak a shumë e kemi krijuar këtë eksperiencë dhe besoj që, qoftë edhe pësimet e marra gjatë këtij procesi në zgjedhjet e shkuara janë bërë mësim. Por, edhe më tej akoma, koha që kemi patur në dispozicion na ka ndihmuar për të analizuar më mirë dhe elementë të tjerë që lidhen me këtë proces. Mendoj që nga pikëpamja e procedurave, e sigurisë edhe e besimit të të gjithë palëve në proces, edhe ky proces do të jetë më mirë i bërë, se ai i zgjedhjeve të 25 prillit. Duke besuar që partitë politike, do të kenë dhe ato për aq sa e kanë këtë rol në këtë proces, përfshirjen e tyre të kërkuar dhe të duhur. Faleminderit! Keni gjë tjetër? Jo, nuk kemi! Mirë, atëherë besoj jemi dakord edhe me përmbajtjen në tërësi të këtij akti, me pikën 1, me pikën 2, me pikën 3, me pikën 4, pikën 5 dhe pikën 6 dhe e miratoj në tërësi projektaktin sipas përmbajtjes propozuar. Kjo ishte dhe pika e fundit e rendit të ditës. Ju falenderoj për kontributet dhe do të vazhdojmë që të jemi në kontakt për më tej, në kuadër të përgatitjes së këtyre zgjedhjeve. Faleminderit dhe ditë të mbarë!

Vendimi nr. 4

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

